

V E N D I M
Nr.51, datë 4.2.1999

**PËR MIRATIMIN E GRANTIT JAPONEZ, ADMINISTRUAR NGA SHOQATA
NDËRKOMBËTARE E ZHVILLIMIT (IDA), PËR PROJEKTIN E REFORMËS SË
ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE GJYQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e grantit japonez, administruar nga Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA), për projektin e reformës së administratës publike e gjyqësore, për shumën 573 700 USD.
 2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko